



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me:	25.11	2024
Prilbuar:		
Nr. i regjistruar:		
Jedrit:		
01-300/01-58606		Shtojca Dodatak



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 04.06.2008, nenit 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit, Nr.110-78095 i datës 24.12.2021 si dhe pikes 4 të Memorandumit të Mirëkuptimit të lidhur në mes të Tetra Tech ARD, Inc. dhe Komunës së Lipjanit Nr.1-016/01-52730 të datës 29.09.2022, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

VENDIM PËR THEMELIMIN KËSHILLIT PUBLIK PRIVAT NË KOMUNËN E LIPJANIT

Neni 1

Themelimi

Me këtë Vendim themelohet Këshilli Publik Privat në Komunën e Lipjanit, (në vazhdim të tekstit KPP)

Neni 2

Qëllimi

Themelimi i KPP-së bëhet me qëllim të krijimit të një trupi konsultativ dhe këshillëdhënës për të ndarë përvojat dhe për të lehtësuar konsultimet ndërmjet Kryetarit të Komunës dhe Sektorit Privat. Qëllimi kryesor i këtij Këshilli është avansimi i vazhdueshëm i bashkëpunimit të nivelit lokal me sektorin privat biznesor për të mbajtur dhe avansuar tutje ambientin e mirë të të bërit biznes si dhe për të nxitur investimet në Komunën e Lipjanit.

Neni 3

Objektivat dhe Roli i KPP

I. Këshilli Publik-Privat ka për qëllim kryerjen e këtyre funksioneve specifike:

1.1 Këshillimi dhe Ndihmesa për Kornizën Ligjore: Këshilli do të veprojë si forum për komunikim të drejtpërdrejtë dhe produktiv ndërmjet Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesve të sektorit privat, me fokus në përmirësimin e kornizës ligjore për bizneset përkitazi me aktet e ndryshme të komunës me qëllim të sigurimit të një mjedisi të favorshëm për bizneset në Komunën e Lipjanit.

1.2 Përfshirja në njoftimin e përvitshëm për listën e pronave komunale për marrje në shfrytëzim për çdo vit paraprak sipas legjislacionit në fuqi: Këshilli do të njoftohet për procesin e listës së pronave komunale që do të jepen për shfrytëzim, në përputhje me Planin Zhvillimor Komunal, Hartën Zonale të Komunës si dhe prioritetet e zhvillimit lokal për çdo vit kalendarik.

- 1.3 Dialog dhe Konsultim për Dokumentet dhe Planet Strategjike Komunale: Këshilli do të konsultohet dhe dialogojë lidhur me rregulloret komunale që ndikojnë në zhvillimin e biznesit, përfshirë buxhetin komunal, planin e prokurimit, dokumentet strategjike komunale dhe çështje të tjera të propozuara nga Kryetari ose përfaqësues të sektorit privat.

Neni 4 **Përbërja e Këshillit Publik-Privat**

1. Këshilli do të përbëhet nga:

- 1.1 Anëtarë nga Komuna: Drejtorët përkatës të të gjitha Drejtorateve të përfshira në fushat me interes për sektorin privat.
- 1.2 Përfaqësues të Sektorit Privat: Përfaqësues të kompanive të mëdha që veprojnë në Komunën e Lipjanit, të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë në përmirësimin e klimës së biznesit dhe zhvillimin ekonomik të komunës.
- 1.3 Përfaqësues të shoqatave të bizneseve që operojnë në komunë.
- 1.4 KPP do të veprojë në baza vullnetare pa ndonjë kompensim të caktuar.

Neni 5 **Organizimi i Takimeve**

1. Këshilli Publik-Privat do të mbledhet së paku tre herë në vit me mundësi për takime shtesë kur është e nevojshme.
2. Takimet do të drejtohen nga Kryetari/Nënkryetari i Komunës së Lipjanit apo Drejtori për Ekonomi dhe Zhvillim, dhe sipas nevojës, do të ftohen edhe drejtorë të tjerë të drejtorateve komunale që lidhen me temat e diskutimit.
3. Këshilli ka të drejtë të propozojë çështje për diskutim dhe të rekomandojë veprime që janë të rëndësishme për sektorin privat dhe zhvillimin ekonomik të komunës.

Neni 6 **Sekretariati dhe mbështetja administrative**

1. Drejtorati përgjegjës për Ekonomi dhe Zhvillim ofron mbështetje profesionale, administrative dhe teknike për nevojat e takimeve të KPP-së.
2. Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim është përgjegjës për nxjerrjen e udhëzuesit/rregullave të brendshme për funksionimin e KPP-së.

Neni 7 **Hyrja në fuqi**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe ju dërgohet të gjithë drejtorëve të drejtorateve komunale në Komunën e Lipjanit dhe publikohet në ueb faqen zyrtare të komunës.

